



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 112

Tiranë – E enjte, 18 maj 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 425, datë 10.5.2017	Për rregullat e organizimit, funksionimit të komisionit për dhënie të dëshmisë së statusit të punonjësve të industrisë së naftës dhe të gazit, kriteret dhe procedurat për lëshimin e vërtetimit të posaçëm zyrtar..... 5933
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 14, datë 28.4.2017	Për licencimin e sh. a. Ujësjetës-Kanalizime Delvinë..... 5935
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 15, datë 28.4.2017	Për licencimin e sh. a. Ujësjetës-Kanalizime Tepelenë..... 5936
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 17, datë 5.5.2017	Mbi tarifat e ujit për konsum publik për shoqërinë UK Lushnjë Qytet sh.a..... 5936
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 18, datë 5.5.2017	Për licencimin e sh.a Ujësjetës-Kanalizime Krujë..... 5936
Kërkesë e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës nr. 2845, datë 16.5.2017	Për shpronësimet për interes publik, të pasurive pronë private që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza Veriore Korçë (shtesa)”, për pasurinë e llojit “truall”..... 5937

**VENDIM****Nr. 425, datë 10.5.2017****PËR RREGULLAT E ORGANIZIMIT,
FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT PËR
DHËNIEN E DËSHMISË SË STATUSIT
TË PUNONJËSVE TË INDUSTRIË SË
NAFTËS DHE TË GAZIT, KRITERET
DHE PROCEDURAT PËR LËSHIMIN E
VËRTETIMIT TË POSAÇËM ZYRTAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 19, të ligjit nr. 8/2017, “Për statusin e punonjësve të industrisë së naftës dhe të gazit”, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë dhe të ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. NGRIJTJA E KOMISIONIT PËR PAJISJEN ME DËSHMI ZYRTARE IDENTIFIKUESE PËR PUNONJËSIT QË PËRFITOJNË STATUSIN E PUNONJËSVE TË INDUSTRIË SË NAFTËS E TË GAZIT DHE RREGULLAT E FUNKSIONIMIT TË TIJ

1. Pranë ministrisë përgjegjëse për industrinë e naftës dhe të gazit ngrihet Komisioni për pajisjen me dëshmi zyrtare identifikuese për personat që përfitojnë statusin e punonjësit të industrisë së naftës dhe të gazit, me përbërje, si më poshtë vijon:

- 5 përfaqësues nga ministria përgjegjëse për industrinë e naftës dhe të gazit;
- 1 përfaqësues nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale;
- 1 përfaqësues nga Ministria e Financave.

Kryetari i Komisionit është një nga përfaqësuesit e ministrisë përgjegjëse për industrinë e naftës dhe të gazit.

Ministri i Energjisë dhe Industrisë me një urdhër të veçantë cakton kryetarin dhe anëtarët e Komisionit.

2. Komisioni mbledhet për shqyrtimin e kërkesave të aplikantëve jo më vonë se data 10 e çdo muaji pranë ministrisë përgjegjëse për industrinë e naftës dhe gazit. Data e mbledhjes caktohet nga kryetari i Komisionit dhe njoftimi i anëtarëve bëhet jo më vonë se 5 (pesë) ditë para zhvillimit të mbledhjes.

3. Mbledhja e komisionit organizohet pranë ambienteve të ministrisë përgjegjëse për industrinë e naftës dhe gazin. Mbledhja konsiderohet e

vlefshme kur në të marrin pjesë jo më pak se 2/3 e anëtarëve të tij.

4. Në çdo mbledhje të organizuar mbahet procesverbal, në të cilin pasqyrohen pjesëmarrja në komision, diskutimet e anëtarëve të komisionit, si dhe vendimi që merret.

5. Anëtarët e komisionit nuk mund të përfaqësohen në mbledhje nga persona të tjerë.

6. Kur nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe verifikimet e kryera rezulton se nuk plotësohen kushtet e kërkuara, sipas neneve 5 e 7, të ligjit nr.8/2017, “Për statusin e punonjësve të industrisë së naftës dhe të gazit”, dhe të kapitullit II, të këtij vendimi, Komisioni njofton aplikantin për dokumentacionin që mungon dhe të drejtën e tij për ta plotësuar atë. Shqyrtimi i dokumentacionit të plotësuar bëhet në mbledhjen e radhës së Komisionit.

7. Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit, Komisioni merr vendimin përkatës që lidhet me pajisjen ose jo të aplikuesit me dëshmi zyrtare identifikuese. Vendimi merret me të paktën 2/3 e votave të anëtarëve pjesëmarrës në mbledhje. Anëtarët e komisionit, të cilët votojnë kundër, shprehin qëndrimin e tyre të arsyetuar në procesverbalin e mbledhjes.

8. Vendimi i komisionit hartohet i arsyetuar dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e tij, pjesëmarrës në mbledhje.

9. Për çdo aplikim të miratuar nga Komisioni, strukturat përgjegjëse në ministrinë përgjegjëse për naftën dhe gazin përgatitin dëshminë zyrtare identifikuese, e cila nënshkruhet nga kryetari i Komisionit dhe vulozet nga protokollin e ministrisë përgjegjëse për industrinë e naftës dhe të gazit.

10. Formatin e dëshmisë zyrtare identifikuese përmban:

a) titullin e dokumentit: Dëshmia e statusit të punonjësit të industrisë së naftës dhe të gazit (Dëshmia Zyrtare Identifikuese);

b) Numrin e regjistrimit themeltar dhe datën;

c) Të dhënat personale të aplikuesit (emër, mbiemër, atësi, datëlindje, vendbanim dhe fotografi);

ç) Vitet në punë gjithsej në industrinë e naftës dhe gazit, sipas neneve 5 e 7, të ligjit nr. 8/2017, “Për statusin e punonjësve të industrisë së naftës dhe të gazit”;

d) Vitet e punës të kryera sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 9, të ligjit nr. 8/2017, “Për



statusin e punonjësve të industrisë së naftës dhe të gazit”.

11. Në rast refuzimi të kërkesës, aplikuesi i interesuar ka të drejtë të paraqesë ankim në gjykatën kompetente, brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni për refuzimin e aplikimit.

12. Në ministrinë përgjegjëse për industrinë e naftës dhe të gazit mbahet regjistri themeltar i dëshmimeve zyrtare identifikuese për statusin e punonjësve të industrisë së naftës dhe të gazit.

13. Komisioni përfiton një pagesë prej 5 000 (pesë mijë) lekësh për çdo mbledhje të realizuar. Fondet e nevojshme përballohen nga ministria përkatëse ku punojnë anëtarët e Komisionit.

II. DOKUMENTACIONI PËR PAJISJEN ME DËSHMI ZYRTARE IDENTIFIKUESE

1. Të drejtën për marrjen e statusit të punonjësit të industrisë së naftës dhe gazit e kanë naftëtarët dhe ish-naftëtarët që plotësojnë kushtet në përputhje me ligjin nr. 8/2017, “Për statusin e punonjësve të industrisë së naftës dhe të gazit”.

2. Aplikuesi duhet të paraqesë në ministrinë përgjegjëse për industrinë e naftës dhe gazit, pranë Komisionit të ngritur për këtë qëllim sipas pikës 1 të këtij vendimi dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Kërkesën për pajisjen me dëshmi zyrtare identifikuese;

b) Fotokopje të noterizuar të një dokumenti identifikues të aplikuesit;

c) Fotokopje të noterizuar të librezës së punës ose të librezës së pensionit;

ç) Vërtetimin e posaçëm zyrtar lëshuar sipas kreut III, të këtij vendimi;

d) Dy fotografi në format dokumenti.

III. KRITERET DHE PROCEDURAT PËR LËSHIMIN E VËRTETIMIT TË POSAÇËM ZYRTAR

1. Pajisjen me vërtetim të posaçëm zyrtar naftëtarët dhe ish-naftëtarët, si më poshtë vijon:

a) Ish-naftëtarë/naftëtarë që punon ose që ka punuar në industrinë e naftës dhe të gazit në profesionin dhe punën, sipas përcaktimit të vendimit nr. 526, datë 20.12.1958, të Këshillit të Ministrave, “Për ndarjen e punëve në kategori për efekt pensioni”;

b) Ish-naftëtarë/naftëtarë i uzinave mekanike të naftës;

c) Ish-naftëtarë/naftëtarë që përfaqëson personelin inxhiniero-teknik, që punon ose ka punuar në ish-ndërmarrjet e sistemit të naftës, si shpim kërkim, shpim shfrytëzim, prodhim, sizmikë (gjeofizika e kërkim-prodhimit), gjeofizikë kantieriale, mekanikë (shërbimet mekanike për përgatitjen, transportimin, montimin e makinerive e të pajisjeve të industrisë së naftës si dhe në shërbimin e inspektimit dhe emergjencës), institutet gjeologjike dhe teknologjike, të përpunimit, transportit me naftës-jellës dhe gazsjellës.

Për të shmangur çdo paqartësi, personel teknik do të konsiderohet edhe punonjësi që ka kryer apo kryen punë apo profesione të cilat, pavarësisht se nuk listohen në vendimin nr. 526, datë 20.12.1958, të Këshillit të Ministrave, “Për ndarjen e punëve në kategori për efekt pensioni”, përfaqësojnë punë në procese, si shpim-kërkim, shpim-shfrytëzim, prodhim, sizmikë, gjeofizikë kantieriale, mekanikë, institutet gjeologjike dhe teknologjike, përpunim, transport me naftës-jellës dhe gazsjellës.

ç) Punonjësit ose ish-punonjësit që kanë punuar në profesione apo punë sipas përcaktimit të shkronjave “a”, “b” dhe “c” më sipër, të cilët janë aksidentuar në punë, pavarësisht nga kohëzgjatja e punës.

2. Pajisja me vërtetim të posaçëm zyrtar bëhet sipas procedurave të mëposhtme:

a) Për naftëtarët dhe ish-naftëtarët:

i) Ish-naftëtarë/naftëtarë paraqet pranë ndërmarrjes ose institucionit ku ka qenë/është i punësuar kërkesën për t’u pajisur me vërtetim të posaçëm zyrtar, shoqëruar me një fotokopje të noterizuar të librezës së punës. Në rast se ndërmarrja apo institucioni nuk ekzistojnë si subjekte, për shkak të privatizimit/ristrukturimit/shkrirjes/mbylljes apo ndonjë arsye tjetër, vërtetimi lëshohet nga ndërmarrja apo institucioni që disponon arkivin me dokumentacionet përkatëse;

ii) Ndërmarrja ose institucioni përkatës brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e paraqitjes së kërkesës pajis punonjësën me vërtetim të posaçëm zyrtar ku përcaktohen profesioni/profesionet dhe punët e kryera nga ish-naftëtarë/naftëtarë, si dhe kohëzgjatja e punës;



iii) Vërtetimi i posaçëm dorëzohet pranë ministrisë përgjegjëse për industrinë e naftës dhe të gazit për konfirmim;

iv) Ministria përgjegjëse për industrinë e naftës dhe të gazit bën konfirmimin brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e paraqitjes së kërkesës.

b) Për ish-naftëtarët që kanë dalë në pension:

i) Ish-naftëtari paraqet kërkesën pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore ose në degët rajonale ku është depozituar librezja e punës së ish-naftëtarit, për t'u pajisur me vërtetim të posaçëm zyrtar;

ii) Instituti i Sigurimeve Shoqërore ose degët rajonale, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e paraqitjes së kërkesës, pajis punonjësën me vërtetim të posaçëm zyrtar ku përcaktohen profesioni/profesionet dhe punët e kryera nga ish-naftëtari, si dhe vitet përkatëse të punës;

iii) Vërtetimi i posaçëm dorëzohet pranë ministrisë përgjegjëse për industrinë e naftës dhe të gazit për konfirmim;

iv) Ministria përgjegjëse për industrinë e naftës dhe të gazit bën konfirmimin brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e paraqitjes së kërkesës.

c) Për ish-naftëtarët dhe naftëtarët, të cilët kanë pasur marrëdhënie pune në shtetet e tjera në profesionet e përcaktuara në nenin 2, të ligjit nr. 8/2017, "Për statusin e punonjësve të industrisë së naftës dhe të gazit":

i) Vërtetimi i posaçëm për periudhën e kohës që naftëtari apo ish-naftëtari ka punuar pranë ndërmarreve apo institucioneve shqiptare të industrisë së naftës lëshohet në përputhje me parashikimet e shkronjave "a" dhe "b", të pikës 2, të kapitullit III;

ii) Vërtetimi i posaçëm për periudhën e kohës që naftëtari apo ish-naftëtari ka pasur marrëdhënie pune në shtetet e tjera, lëshohet nga subjekti juridik i shtetit të huaj në të cilin ka punuar naftëtari/ish-naftëtari apo institucione të tjera zyrtare, sikurse parashikon legjislacioni i shtetit tjetër. Ky vërtetim paraqitet për konfirmim pranë ministrisë përgjegjëse për industrinë e naftës dhe të gazit dhe Institutin e Sigurimeve Shoqërore;

iii) Instituti i Sigurimeve Shoqërore, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e paraqitjes së kërkesës, pajis punonjësën me vërtetim zyrtar, ku përcaktohet se Republika e Shqipërisë ka marrëveshje në fushën e mbrojtjes shoqërore me shtetin përkatës;

iv) Ministria përgjegjëse për industrinë e naftës dhe të gazit bën konfirmimin brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e paraqitjes së vërtetimit nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, ku përcaktohet se Republika e Shqipërisë ka marrëveshje në fushën e mbrojtjes shoqërore me shtetin përkatës.

3. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë, shoqëritë dhe institucionet që operojnë në industrinë e naftës dhe gazit dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM
Nr. 14, datë 28.4.2017

PËR LICENCIMIN E SH. A UJËSJELLËS KANALIZIME DELVINË

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar si dhe VKM nr. 958, datë 6.5.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë", Komisioni Kombëtar Rregullator,

VENDOSI:

1. Licencimin e operatorit Sh.a Ujësjiellës Kanalizime Delvinë me:

Drejtues Ligjor Bati Çuçuri
Drejtues Teknik Vani Toti

2. Operatori Sh.a Ujësjiellës Kanalizime Delvinë autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategorinë:

Kategoria A, për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

Kategoria C, për largimin e ujërave të ndotura;

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është:

Bashkia Delvinë

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4 (katër) vjeçare.

KRYETARI
Ndriçim Shani



VENDIM
Nr. 15, datë 28.4.2017

PËR LICENCIMIN E SH. A UJËSJELLËS
KANALIZIME TEPELENË

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, si dhe VKM nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, Komisioni Kombëtar Rregullator,

VENDOSI:

1. Licencimin e operatorit Sh.a Ujësjiellës Kanalizime Tepelenë me:

Drejtues Ligjor Arben Kacorri
 Drejtues Teknik Amarildo Tola

2. Operatori Sh.a Ujësjiellës Kanalizime Tepelenë autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategorinë:

Kategoria A, për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

Kategoria C, për largimin e ujërave të ndotura;

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është:

Bashkia Tepelenë

Bashkia Memaliaj

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4 (katër) vjeçare.

KRYETARI
Ndriçim Shani

VENDIM
Nr. 17, datë 5.5.2017

MBI TARIFAT E UJIT PËR KONSUM
PUBLIK PËR SHOQËRINË UK LUSHNJË
QYTET SHA

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21, të ligjit nr. 8102 datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar dhe Metodologjisë “Për vendosjen e tarifave” Komisioni Kombëtar Rregullator,

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë U K Lushnjë Qytet Sha :

Faqe | 5936

a) Tarifë volumetrike për shërbimet:

	Furnizim me ujë	Largimi i ujërave të ndotura
Konsumator familjar	58 lekë/m ³	17 lekë/m ³
Konsumator publik	130 lekë/m ³	21 lekë/m ³
Konsumator privat	140 lekë/m ³	24 lekë/m ³

b) Tarifë fikse

Konsumator familjar	100 lekë/muaj/klient
Konsumator publik	200 lekë/muaj/klient
Konsumator privat	200 lekë/muaj/klient

c) Shitje uji me shumicë 32 lek/m³

2. Objektivat e Treguesve Kryesorë të Performancës për vitin 2017:

- uji pa të ardhura (humbjet)	72 %
- niveli i matjes	100 %
- kohëzgjatja e furnizimi	7 orë/ditë
- eficienta e stafit	5.29 p/000/lidhje
- mbulimi me ujë	80 %
- mbulimi me kanalizime	50 %
- norma e arkëtimit	90 %
- cilësia e ujit (klor+koliform)	sipas standarteve

3. Pagesa rregullatore vjetore për UK Lushnjë Qytet Sha do të jetë 0.6% e të ardhurave të llogaritura.

4. Vendimi KKRR nr. 6, datë 10.3.2014 “Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për Sha U K Lushnjë qytet” shfuqizohet.

5. Ky vendim hyn në fuqi më 1.6.2017 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

KRYETARI
Ndriçim Shani

VENDIM
Nr. 18, datë 5.5.2017

PËR LICENCIMIN E SH. A UJËSJELLËS
KANALIZIME KRUIJË

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 958, datë 6.5.2009



“Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, Komisioni Kombëtar Rregullator,

VENDOSI:

1. Licencimin e operatorit Sh.a Ujësjetllës Kanalizime Krujë me:

Drejtuesi Ligjor Ledio Çela

Drejtuesi Teknik Rexhep Llega

2. Operatori Sh.a Ujësjetllës Kanalizime Krujë autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategorinë:

Kategoria A, për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

Kategoria C, për largimin e ujërave të ndotura;

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është:

Bashkia Krujë

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4 (katër) vjeçare.

**KRYETARI
Ndriçim Shani**

KËRKESË

Nr. 2845, datë 16.5.2017

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën “Për shpronësimet për interes publik, të pasurive pronë private që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza Veriore Korçë) (shtesa)”, për pasurinë e llojit “truall”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vemë në dijeni personat të

cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni, konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përlllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, i ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, tirullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasurinë e llojit “truall”. Pronarët do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”.

Vlera totale e shpronësimit është 738 430 (shtatëqind e tridhjetë e tetë mijë e katërqind e tridhjetë) lekë.

**ZËVENDËSMINISTRI I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
Bahri Shaqiri**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRI E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “UNAZA VERIORE KORÇË (SHTESA)”

PRONARI				Z.Kad.	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip.e shpronësuar (m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera totale (lekë)	Shënime
Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri							
1	Llambi	Andon	Tona	8563	2/150	Truall	98	7535	738430	Konfirmuar nga ZVRPP
SHUMA									738430	

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”

Çmimi 56 lekë